# RREGULLORE

## "MBI MENAXHIMIN E PROCESIT TË NDËRHYRJEVE TË NEVOJSHME PËR RIGJENERIMIN DHE SHËNDETËSIMIN E EKOSISTEMEVE DHE FURNIZIMIN E KOMUNITETIT DHE SUBJEKTEVE PRIVATE LOKALE ME MATERIALIN DRUSOR | ASORTIMENTET E REALIZUARA"

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM,
Nr. 312, datë 09.09.2024

## AKZM |

## AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT, MONITORIMIT DHE REGJISTRIT**
**SEKTORI I MENAXHIMIT**

nr 3018 prot

**U R D H Ë R**
Nr 312, datë 09.08.2024

**PËR**
**MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI MENAXHIMIN E PROCESIT TË NDËRHYRJEVE TË NEVOJSHME PËR RIGJENERIMIN DHE SHËNDETËSIMIN E EKOSISTEMEVE DHE FURNIZIMIN E KOMUNITETIT DHE SUBJEKTEVE PRIVATE LOKALE ME MATERIALIN DRUSOR/ASORTIMENTET E REALIZUARA"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017 "Për Zonat e Mbrojtura", të ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar, Vendimit nr. 102, datë 4.2.2015 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", të ndryshuar, Vendimit nr. 1156, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administratave rajonale të zonave të mbrojtura", miratuar me Urdhrin nr. 72/1, datë 15.06.2015, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Rregullores "Mbi menaxhimin e procesit të ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor | asortimentet e realizuara", bashkëlidhur këtij urdhri;
2. Rregullorja "Mbi mënyrën e vjeljes dhe pagesës së tarifës së materialit drusor të rezultuara nga kryerja e punimeve të shëndetësimit apo dhe nga faktorët natyrorë, brenda territorit të zonave të mbrojtura mjedisore" miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.1169, datë 27.09.2021, shfuqizohet;
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe strukturat e tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**I KOMANDUAR NË DETYRË**
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Daniel PIRUSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

## RREGULLORE "MBI MENAXHIMIN E PROCESIT TË NDËRHYRJEVE TË NEVOJSHME PËR RIGJENERIMIN DHE SHËNDETËSIMIN E EKOSISTEMEVE DHE FURNIZIMIN E KOMUNITETIT DHE SUBJEKTEVE PRIVATE LOKALE ME MATERIALIN DRUSOR/ASORTIMENTET E REALIZUARA"

### Neni 1
### Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve dhe rregullave mbi menaxhimin e procesit të ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor | asortimentet e realizuara në Zonat e Mbrojtura Mjedisore.

### Neni 2
### Subjekt i rregullores

Subjekt i kësaj rregulloreje janë Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe strukturat e tyre. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë subjekt i kësaj rregullore, për sa kohë pranojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë akt me anë të deklaratës së firmosur prej tyre (Aneksi 1).

### Neni 3
### Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në zbatim të:
1. Ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017 "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 81/2017; i ndryshuar;
2. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;
3. Vendimit nr. 102, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", i ndryshuar;
4. Vendimit nr. 1156, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre", i ndryshuar;
5. Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; dhe
6. akteve të tjera nënligjore në fuqi.

### Neni 4
### Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
a) **AKZM** - është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe ka kuptimin që i jep ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
b) **AdZM** - janë Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe kanë kuptimin që i jep ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
c) **Zonë e mbrojtur mjedisore (ZMM)** - ka kuptimin që i jep ligji nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
d) **Rigjenerim** - ka kuptimin që i jep ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
e) **Shëndetësim** - ka kuptimin që i jep ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
f) **Tarifa** – janë tarifat e miratura të materialit drusor/asortimenteve të rezultuara nga kryerja e punimeve të shëndetësimit apo dhe nga faktorët natyrorë;

g) **Komunitet** - janë familjet me banim të përhershëm në njësitë e vetqeverisjes vendore, që ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura mjedisore;
h) **Subjekte private** – janë persona me status juridik/personal fizik të cilët rezultojnë të rregjistruar në QKB dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda zonës së mbrojtur mjedisore;
i) **Kryetari i bashkisë** – ka kuptimin që i jep Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar;
j) **Administratori i njësisë** – ka kuptimin që i jep Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar;
k) **Kryetari i fshatit** – ka kuptimin që i jep Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

**Neni 5**
**Qëllimi dhe Parimet**

1. Kjo rregullore ka për qëllim të sqarojë në detaje procedurat që ndiqen për procesin e ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor/asortimentet e realizuara në Zonat e Mbrojtura Mjedisore. Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjorë në fuqi:
a) Pyjet në zonat e mbrojtura mjedisore përjashtohen nga klasifikimi si pyje prodhuese;
b) Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore, sipas projektit teknik dhe me miratim të AKZM-së;
c) Administrata e ZMM i ushtron këto veprimtari drejtpërdrejtë, nëpërmjet komunitetit lokal dhe/ose një subjekti të autorizuar prej saj;
d) Materiali drusor i rezultuar i shitet në radhë të parë komunitetit, i cili ndodhet brenda territorit të ZMM-së, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, gatim a përdorime të tjera vetjake, si dhe më pas subjekteve private brenda ZMM-së;
e) Në rastet kur punimet do të kryhen në pronat private, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja, pronari ka të drejtë të veprojë në përputhje me interesat e tij për materialin drusor që do të rezultojë;
2. Parimet kryesore mbi bazën e të cilave hartohet kjo rregullore janë:
a) Parimi i sigurimit të përmirësimeve maksimale për ekosistemin dhe habitatin, treguesit biologjikë, mjedisorë, turistikë dhe infrastrukturorë;
b) Parimi i mos cënimit të vlerave natyrore, mjedisore, turistike dhe funksionet e tyre;
c) Parimi i sigurimit të përfitimeve social-ekonomike për komunitetet lokale;
d) Parimi i barazisë, me synim trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të të gjithë pjestarëve të komunitetit dhe subjekteve private, sipas rradhës prioritare;
e) Parimi i sigurimit të pjesëmarrjes së komunitetit dhe subjekteve private në procedurat;
f) Parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe arritjes së transparencës në procedurat e ndjekura;
g) Parimi i ligjshmërisë dhe i menaxhimit të shëndoshë financiar;
h) Parimi i kontrollit dhe ndarjes së detyrave të papajtueshme.

**Neni 6**
**Hartimi, miratimi dhe raportimi i projektit teknik**

1. Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë

si pasojë e emergjencave natyrore, sipas projektit teknik të hartuar nga AdZM dhe miratuar nga AKZM.

2. Brenda muajit maj të cdo viti, për ndërhyrjet e parashikuara në planin e menaxhimit në fuqi, ose kur vlerësohet e nevojshme si pasojë e emergjencave natyrore, AdZM harton projektin teknik në lidhje me ndërhyrjet për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme dhe e depoziton atë për miratim në AKZM. Dokumentacioni teknik dhe tabelar që do të përgatitet gjatë këtij procesi janë:

a) Projekti teknik që hartohet për sipërfaqen pyjore;
b) Proceset teknike për vjeljen e materialeve drusorë (mënyrat dhe teknikat që do të zbatohen);
c) Tabelat që do të ndërtohen për sasitë, moshën dhe llojet e materialit drusor;
d) Hartat e parcelave pyjore dhe të sipërfaqeve që do të përshkohen gjatë procesit.

3. Projekti teknik duhet të detajojë në nivel ZMM, zone (objekti), ekonomie pyjore, ngastrën dhe nën ngastrën:

a) Kategorinë e zonës së mbrojtur mjedisore (shkallën e mbrojtjes), si dhe zonimin e brendshëm të zonës së mbrojtur mjedisore;
b) Gjendjen reale të zonës së mbrojtur (shkallën e dëmtimit nga prerjet, zjarret, fenomenet natyrore dhe zhvillimi biologjik i pemëve);
c) Caktimin e numrit të pemëve (drurëve pyjorë) që do të hiqen duke bërë dhe klasifikimin e llojeve (specieve) drusore për të ruajtur biodiversitetin. Vlerësimin e pemëve (drurëve pyjorë) të rrëzuar, thyer, tharë, prekur nga sëmundje, etj;
d) Trajtimin rehabilitues (përshkrimi projektit) që do të zbatohet; rrallime, çlirime (hapje koridoresh), pastrime higjeno – sanitare nga patologji të ndryshme, dëmtime nga faktorë natyrorë etj;
e) Sasinë dhe volumin e planifikuar të materialit drusor që rezulton nga kryerja e trajtimit.

Sa më lart përmblidhet edhe në Tabelën Përmbledhëse për Objektet e Shëndetësimit të Pyjeve (Aneksi 2).

4. Projekti Teknik i përgatitur dhe dokumentat shoqërues shqyrtohet nga strukturat e Drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM brenda dy muajsh, duke kontrolluar si elementët e përputhshmërisë ligjore të ndërhyrjes, plotësinë e dokumentacionit të hartuar, argumentimin e nevojës për ndërhyrje, përshtatshmërinë e teknikave të propozuara, intensitetin e ndërhyrjeve dhe arsyeshmërinë e sasive të materialit drusor të vlerësuar për t`u gjeneruar.

5. Pas shqyrtimit Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin harton një informacion (Aneks 3) të detajuar dhe argumentuar për Drejtorin e Përgjithshëm të AKZM-së ku propozon miratimin e Projektit Teknik siç propozuar nga AdZM, miratimin e Projektit Teknik me ndryshime, ose refuzimin e Projektit Teknik të propozuar. Në rast të dhënies së dakordësisë për miratim të Projektit Teknik, strukturat e Drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM bashkëfirmosin në Tabelën Përmbledhëse për Objektet e Shëndetësimit të Pyjeve (Aneksi 2), e cila së bashku me Projektin Teknik final shoqëron shkresën informuese.

6. Në rast miratimi të Projektit Teknik, Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin në AKZM harton draft Urdhrin e Drejtorit të Përgjithsëm (Aneks 4), në të përcaktohen dhe afatet dhe periudha e kryerjes së ndërhyrjeve të parashikuara në Projektin Teknik. Periudha e kryerjes së ndërhyrjeve merr në konsideratë edhe kohën e nevojshme për njoftimin e komunitetit lokal dhe hartimin e listës së banorëve përfitues. Një kopje e Urdhrit të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i dërgohet për zbatim AdZM-së përkatëse. Për cdo ndryshim të Projektit Teknik apo afateve/periudhës kërkohet miratim i ri nga AKZM-ja.

7. Brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të realizimit të ndërhyrjeve, AdZM përgatit dhe dorëzon në AKZM një relacion të hollësishëm mbi të gjithë procesit dhe rezultatet e

arritura. Ky relacion dorëzohet në AdZM së bashku me kopje të të gjithë dokumentacionit mbështetës dhe shoqërues (trajtuar më poshtë).
8. Pas kontrollit të relacionit përfundimar dhe dokumentacionit, strukturat e Drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM, brenda 10 ditëve dërgojnë informacion tek Drejtori i Përgjithshëm mbi përfundimin e procesit dhe rezultatet e arritura. Rezultatet faktike përmblidhen në Tabelën Përmbledhëse për Objektet e Shëndetësimit të Pyjeve (Aneksi 5).

**Neni 7**
**Hartimi, njoftimi dhe miratimi i listës së komunitetit përfitues**

1. Menjëherë pas miratimit të Projektit Teknik, AdZM-ja koordinon me Njësinë e Vetqeverisjes vendore për hartimin e listës së komunitetit me banim të përhershëm në ZMM që ka të drejtë të përfitojë material drusor nga ndërhyrjet e planifikuara në ekosistem.
2. AdZM i vë në dispozicion Njësisë së Vetqeverisjes Vendore një kopje të Projekti Teknik të miratuar dhe njofton për sasinë totale të parashikuar të materialit drusor që planifikohet të gjenerohet nga ndërhyrjet.
3. Njësia e Vetqeverisjes Vendore harton brenda 5 ditëve Listat e familjeve me banim të përhershëm në ZMM që kanë të drejtë të marrin pjesë në proces dhe përfitojnë material drusor, sipas të dhënave dhe konfirmuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Aneksi 6). Një kopje e kësaj liste të finalizuar dërgohet në AdZM.
4. Njësia e Vetqeverisjës Vendore dhe strukturat e saj janë përgjegjëse për njoftimin e familjeve me banim të përhershëm që kanë të drejtë përfitimi për dru zjarri. Realizimi i këtij procesi dokumentohet në formularin "Njoftimi i Familjeve me Banim të Përhershëm që kanë të Drejtë Përfitimi për Dru Zjarri" (Aneksi 7). Lista e familjeve që kanë të drejtë të përfitojnë shpallet në qendër të fshatit, në Njësitë Administrative dhe në Bashki për një afat 10 ditor, si dhe kryefamiljarët/familjarët njoftohen individualisht nga Kryetari i Fshatit. Lista përfshinë të gjitha familjet e listuara në Aneksin 6. Nëse nuk gjenden perfituesit, marrja dijeni konsiderohet e ezauruar me përmbushja e afatit 10 ditor dhe kryerjen e njoftimit individual nga Kryetari i Fshatit. Në këtë rast në formular vendoset data e njoftimit nga Kryetari i Fshatit dhe shënimi përkatës. Familjaret që shprehin interes për të përfituar dru zjarri, plotësojnë më shkrimin e tyre të dhënat në Aneksin 8. Një kopje e kësaj liste të finalizuar dërgohet në AdZM.
5. Në përfundim të procesit të njoftimit nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore finalizohet "Lista e familjeve me banim të përhershëm që kanë shprehur interes për dru zjarri" (Aneksi 8). Kjo listë dërgohet në AdZM për miratim në parim në parim.
6. AdZM, bazuar në numrin e familjeve që kanë shprehur interes, si dhe në sasinë totale të materialit drusor të parashikuar në Projektin Teknik, llogarisin sasinë mesatare të materialit drusor që mund të përfitojë një familje. Kjo shifër i njoftohet strukturave të Njësisë së Vetqeverisjes Vendore të cilat janë përgjegjëse, me anë të Kryetarit të Fshatit të njoftojnë banorët. Nëse familje të catuara shprehin interes për sasi më të vogla të materialit drusor, sasisë në tepricë mund t`i alokohen në mënyrë të barabartë familjeve që kanë shprehur interes për sasi më të mëdha. Ky proces dokumentohet dhe nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore hartohet lista finale me sasinë sipas familjeve (Aneksi 9) që miratohet në parim nga AdZM.
7. Për rastet kur nuk mund të plotësohet të gjitha nevojat e komunitetit, nevojat e paplotësuara të mundësohen nga pushteti vendor.

**Neni 8**
**Kalendari i punimeve dhe trajnimi i komunitetit dhe stafit**

8. Procesi i grumbullimit të materialit drusor, në parcelat e planifikuara në projektin teknik për zbatim që miratohet, do të kryhet nga vetë banorët e zonës ose strukturat e bashkisë, nën drejtimin teknik të strukturave menaxhuese të AdZM-së.
9. Kryefamiljarë të moshuar ose në paaftësi mund të caktojnë një pjestar tjetër të familjes së tyre, ose një të afërm të tyre me banim të përhershëm në ZMM për kryerjen e procesit. Në këtë rast ata lëshojnë një deklaratë me shkrim që depozitohet në AdZM.
10. Strukturat e Njësisë së Vetqeverisjës Vendore dhe AdZM-së hartojnë një kalendar pune me emrat e kryefamiljarëve, datat dhe fashat orare kur ata duhet të paraqiten, me qëllim mirëorganizimin e punës. Kryetarët e fshatit janë përgjegjës për njoftimin e banorëve për kalendarin e punës dhe datat e përcaktuara. Prioritet në caktimin e ditëve të paraqitjes i jepet kryfamiljarëve me pjestarë në familje të personave me aftësi të kufizura, kryefamiljarëve nëna me fëmijë vetëm në ngarkim, familjeve me ndihmë ekonomike dhe familjeve që kanë në përbërje vetëm të moshuar. Në rastet e tjera, ndiqet radha alfabetike sipas mbiemrit.
11. Përpara fillimit të ndërhyrjeve në terren, sipas kalendarit të punës dhe fashave orare, komuniteti dhe stafi i bashkisë që marrin pjesë dhe kanë rol në zbatimin e Projektit Teknik, trajnohen në lidhje me procedurat, ndërhyrjet e lejuara dhe teknikat e miratuara për vjeljen e materialit drusor nga stafi i AdZM-së. Ky proces dokumentohet në formularin "Regjistri për Trajnimin e Komunitetit dhe Stafit të Bashkisë" (Aneksi 10).

**Neni 9**
**Njoftimi i organeve përgjegjëse për mbrojten e territorit**

1. AdZM është përgjegjëse për njoftimin e organeve përgjegjëe për mbrojtjen e territorit, IKMT dhe Policinë e Shtetit, në lidhje me zbatimin e ndërhyrjeve në pyje dhe periudhën në të cilën ajo do të shtrihet (Aneksi 11 dhe 12).
2. Për cdo ndryshim në objekt, afate apo periudhën e realizimit të procesit, AdZM rinjofton këto organe menjëherë.

**Neni 10**
**Dorëzimi dhe kolaudimi i sipërfaqeve pyjore**

1. Në fillim të procesit të ndërhyrjeve, AdZM-ja i dorëzon me procesvebal (Aneksi 13) strukturave të Njësisë së Vetqeverisjes Vendore sipërfaqet pyjore objekt shëndetësimi. Në të përcaktohet dhe përgjegjësitë e palëve, si dhe ky procesverbal shoqërohet më fotografim të terrenin nga zonat e përcaktuara për ndërhyrje.
2. Në përfundim të procesit të ndërhyrjeve hartohet Akti i kolaudimit (Aneksi 14) që dokumenton rezultatet e procesit dhe marrjen në dorëzim të sipërfaqeve pyjore nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore tek AdZM-ja. Ky dokument shoqërohet më fotografim të terrenit nga zonat e përcaktuara për ndërhyrje që tregojnë rezultatet e arritura.
3. Gjatë procesit të ndërhyrjeve, Njësia e Vetqeverisjes Vendore raporton pranë AdZM-së në çdo moment për problematikat e konstatuara gjatë menaxhimit të shëndetësimit të pyllit dhe të pasurive pyjore.

**Neni 11**
**Grumbullimi dhe shpërndarja e materialit drusor**

1. Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, në bashkëpunim me AdZM-në, përcakton në afërsi të cdo ngastre (dhe afër daljes në rrugë transporti) një hapësirë për vendgrumbullimin e

përkohëshëm të materialit drusor të gjeneruar nga procesi i shëndetësimit. Kjo hapësirë ruahet 24/7 nga policia bashkiake deri në dorëzimin e materialit drusor tek banorët përfitues.
2. Pas kryerjes së procesit të grumbullimit të materialit drusor, personat e autorizuar sipas regjistrave përkatës, e zbresin atë në hapësirën e përcaktuar ku dhe behët matja dhe regjistrimi i sasive në Regjistrin e stivosjes së materialit drusor (Aneksi 15).
3. Përfituesit e materialit drusor mund të bëjne transportimin e sasisve të materiali vetëm pasi ajo është autorizuar dhe regjistruar në Regjistrin e shpërndarjes dhe dorëzimit të materialit drusor (Aneksi 16). Cdo shpërndarje e materialit drusor rregjistrohet për cdo transport/dorëzim në datën që ka ndodhur dhe për sasinë përkatëse të atij transporti/dorëzimi.
4. Për transportin e materialit dhe marrjen e tij në dorëzim, banorëve lokalë i lëshohet Vërtetimi për shoqërimin e materialit drusor (Aneksi 17 ose Aneksi 17.1 për rastet kur nevojitet kryerja e disa rrugëve dhe vetëm nëse transporti bëhet me kafshë samari).
5. Shpërndarja e materialit drusor dhe lëshimi i vërtetimit bëhet vetëm nëse nga përfituesi është kryer pagesën për të gjithë sasinë e përfituar sipas tarifave në fuqi. Vërtetimi i lëshuar është i pa vlefshëm nëse nuk shoqërohet me kopje të faturës për arkëtim të lëshuar dhe vërtetimi pa pagesës.
6. Njësia e Vetëqeverisjes Vendore mundëson që në përfundim të procesit të shëndetësimi në rast të rezultimit të tepricës së materialit drusor ta magazinojë për llogari të AdZM, pa pagësë.

**Neni 12**
**Faturimi, arkëtimi, regjistirimi dhe rakordimi i pagesave të shpërndarjes**

1. AdZM i lëshon cdo banori përfitues një faturë për arkëtim sipas formatit, Aneksi 18.
2. Banorët e kryejnë pagesën në Bankat e nivelit të dytë osë ne zyrën e Postës Shqiptare, ku kryejnë dhe shërbimet e tjera si pagesa, apo marrje pensioni. AdZM sigurohet të koordinojë me strukturat lokale të Postës Shqiptare për dhënien e këtij shërbimi. Tarifat e shërbimit të pagësës nga bankat dhe Posta janë përgjegjësi e banorëve.
3. Me dorëzimin e një kopje të vërtetimit të pagesës së kryer të lëshuara nga Bankat e nivelit të dytë ose Posta Shqiptare, banori ka të drejtë të marrë në dorëzim sasinë e materialit drusor dhe lëshimin e vërtetimit të transportit.
4. Të gjitha faturat e lëshuara dhe statusi i tyre regjistrohen nga AdZM në "Regjistrin e faturave për arkëtim" (Aneksi 19).
5. Në përfundim të procesit, nëpërmjet strukturave të AdZM-së dhe atyre të Njësisë së Vetqeverisjes Vendore, mbahet "Proces - Verbali për Rakordimin e shpërndarjes dhe transportit të druve të zjarrit" (Aneksi 20).

**Neni 12**
**Kontrolli financiar**

1. Në përfundim të procesit, kopje e të gjithë praktikës dokumentare dorëzohet nga AdZM-ja në AKZM.
2. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe të dhënat e thesarit, Drejtoria përgjegjëse për financat në AKZM kryen rakordimin me derdhjet sipas nxjerrjes së llogarisë nga Thesari. Ky proces dokumentohet sipas Ankesit 21 dhe njoftohen për rezultatet e procesit AdZM, Drejtoria përgjegjëse për monitorimin në AKZM dhe Drejtori i Përgjithshëm.

**Neni 13**
**Llogaritja e kostos së prodhimit dhe shpërndarja për asortimentet e gjeneruara**

1. Pas mbulimit të nevojave për komunitetin, asortimentet e prodhuara, ose materialit drusor i shpërndahet subjekteve privatë që operojnë në ZMM duke hartuar dhe miratuar një Projekt të vecantë Teknik. Kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjorë, si dhe të kësaj rregulloreje janë të zbatueshme edhe në këtë rast, si për cdo ndërhyrje tjetër rigjeneruese dhe shëndetësuese. Plotësimi i kërkesave do të jetë në varesi të studimit dhe mundësisë së furnizimit me asortimente drusore.
2. Subjektet private njoftohen nga AdZM për mundësinë e përfitimit dhe tarifat përkatëse. Procesi i njoftimit, i cili mund të jetë dhe elektronik, duhet të dokumentohet. Subjektet private mund të dorëzojnë kërkesat e tyre pranë AdZM-së për trajtim së bashku me një ekstrakt të regjistrimit në QKB-së. Nga strukturat menaxhuese të AdZM-së kryhen verifikimi për statusin e subjektit, nëse ai rezulton qe të jetë aktiv dhe me aktivitet vetëm në zonën e mbrojtur, e më pas vijohet me shqyrtimin e kërkesës. Subjektet informale me AdZM-në (kanë territore informale nën administrimin e AKZM-së) nuk përfitojnë nga kjo e drejtë. Për njoftimin e komunitetit për asortimentet zbatohen të njëjtat procedura sic përcaktuar për materialin drusor.
3. AdZM-të llogarisin koston e prodhimit për asortimente drusore duke përdorur metodologjinë në Aneksin 22 ose normativa kostimi të përcaktuara në akte të tjera ligjore dhe Vendime të Këshillit të Ministrave për asortimente të ngjashme. Kjo llogaritje konfirmohet nga strukturat përgjegjëse për financat në AKZM dhe miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së përpra faturimit ndaj përfituesve.
4. Procedura e grumbullimit, shpërndarjes, faturimit, arkëtimit dhe raportimit, ndjek të njëjtat procedura dhe dokumentim sic parashikuar në rastet e materialit drusor.

**Neni 14**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**Neni 15**
**Dispozita të fundit**

1. Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe konsiderohen dokumenta/formate tip të cilat mund të pësojnë ndryshime sipas nevojave të raportimit.
2. Dokumentat e kërkuara në këtë rregullore, por që nuk janë pjesë e shtojcave, hartohen nga AdZM-të duke mbajtur në konsideratë elementët e detyrueshëm në përmbajtjen e tyre.
3. Në raste të refuzimit të përfshirjes në proces të njësive të qeverisjes vendore, AdZM-të vlerësojnë nëse procesi mund të kryet i gjithi nga strukturat e tyre. Në këtë rast dhe pas miratimit nga AKZM, përgjegjësitë që në këtë rregullore mbulohen nga strukturat e njësive të qeverisjes vendore do të mbulohen nga stafi i AdZM-së, duke mbajtur në konsideratë ndarjen e detyrave të papajtueshme. Në këto raste, formatet tip të dokumentimit dhe raportimit përshtaten në bashkëpunim me strukturat e AKZM-së.
4. Në përmbushje të përgjegjësive të përcaktuara në këtë akt dhe në Projektin teknik, Drejtori i AdZM miraton një plan veprimi ku përcaktohen detyrat në nivel punonjësi dhe në nivel sektori dhe garantohet koordinimi me strukturat e njësisë së vetqeverisjes vendore.
5. Për vitin 2024 nuk zbatohen afatet e përcaktuara për hartimin dhe miratimin e Projektit Teknik. Afati për dorëzimin e Projekteve Teknike nga AdZM-të është 20 shtator 2024 dhe afati për shqyrtim nga AKZM është brenda 15 ditëve nga dorëzimi.

## ANEKS 1

DEKLARATË

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë ____________, deklaroj si më poshtë vijon:

1. Jemi njohur me Projektin Teknik mbi ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve në ZMM _______, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura nr. _____, datë _______.
2. Për zbatimin e Projektit Teknik në sipërfaqet e ZMM _____ të cilat ndodhen brenda kufijve administrative të Bashkisë ______, jemi njohur dhe jemi dakord me përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara për strukturat e Bashkisë ______ në Rregulloren "Mbi menaxhimin e procesit të ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor/asortimentet e realizuara", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave nr. _____, datë 09.09.2024.
3. Bashkia ________ ka dhe do të vendosë në dispozicion stafin dhe punonjësit e përshtatshëm dhe të nevojshëm, si dhe mjetet dhe/ose makineritë që kërkohen për zbatimin e përgjegjësive dhe detyrave tona brenda afateve të përcaktuara për realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit me materialin drusor/asortimentet e realizuara.

**Për Bashkinë** ______________________________

Emri, Mbiemri ______________________________

Firma ______________________________

Vula______________________________

Data e dorëzimit të deklaratës ______________

## ANEKS 2

**ADZM:** ____________

**ZMM:** ____________

### TABELA PERMBLEDHESE PER OBJEKTET E SHENDETESIMIT TE PYJEVE VITI ______

| Nr | Emërtimi projektit | Objekti | Ekonomia pyjore | Ng./ n.ng. | Lloji drusor | Sip. ha | Volumi i planifikuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | m3 | mst |
| 1 | Pastrimi mbeturinave drusore | Faqe Çeltinës | Qarrishtë | 113a,211a | Ah | 25 | 150 | 250 |
| 2 | Pastrimi mbeturinave drusore | | | | | | | |
| 3 | Pastrim/ shëndetësim pyjesh | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| 4 | Pastrim/ shëndetësim pyjesh | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | TOTALI | | | | | | | |

**Pergjegjesi i Sektorit te Menaxhimit**
Emer, Mbiemër, Firme

____________________

**Drejtori i AdZM** ____________
Emer, Mbiemër, Firme, Vule

____________________

Konfirmoi/ Kontrolloi mbështetur në dokumentacionin mbështetës të dorëzuar nga AdZM:

**Pergjegjesi i Sekt. Menaxhimit në AKZM**
Emer, Mbiemër, Firme

____________________

**Drejtori i Drejtorisë përgjegjëse për Menaxhimin në AKZM**
Emer, Mbiemër, Firme

____________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT, MONITORIMIT DHE REGJISTRIT TË ZONAVE TË MBROJTURA**
**SEKTORI I MENAXHIMIT**

Nr. _____ prot. Tiranë, më___.___.202_

**ANEKS 3_M E M O**

---

**Lënda:** Informacion për vlerësimin dhe miratimin e kërkesës "Për miratimin e projekteve për rehabilitimin dhe shëndetësimin e pyjeve në ___________"

**Drejtuar:** Znj. Daniel Pirushi, I komanduar në detyrë, Drejtor i Përgjithshëm

**Miratoi:** Z. ________, Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrit të zonave të mbrojtura

**Konfirmoi:** Z. _________, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit

**Konceptoi:** Z. __________, Specialist i Sektorit të Menaxhimit

---

***Shënim:*** *Projekti Teknik i përgatitur dhe dokumentat shoqërues shqyrtohet nga strukturat e Drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM brenda dy muajsh, duke kontrolluar si elementët e përputhshmërisë ligjore të ndërhyrjes, plotësinë e dokumentacionit të hartuar, argumentimin e nevojës për ndërhyrje, përshtatshmërinë e teknikave të propozuara, intensitetin e ndërhyrjeve dhe arsyeshmërinë e sasive materialit drusor të vlerësuar për tu gjeneruar.*
*Pas shqyrtimit Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin harton një informacion (Aneks 3) të detajuar dhe argumentuar për Drejtorin e Përgjithshëm të AKZM-së ku propozon miratimin e Projektit Teknik siç propozuar nga AdZM, miratimin e Projektit Teknik me ndryshime, ose refuzimin e Projektit Teknik të propozuar. Në rast të dhënies së dakordësisë për miratim të Projektit Teknik, strukturat e Drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM bashkëfirmosin në Tabelën Përmbledhëse për Objektet e Shëndetësimit të Pyjeve (Aneksi 2), e cila së bashku me Projektin Teknik final shoqëron shkresën informuese.*

Në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017, "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 81/2017, i ndryshuar, dhe Rregullores "Mbi menaxhimin e procesit të ndërhyrjeve të

nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor/asortimentet e realizuara", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave nr. _____, datë ________, kemi shqyrtuar Projektin Teknik dhe dokumentat shoqërues të hartuara nga AdZM ___________ dhe paraqitura me shkresën nr. _____, datë ________ pranë AKZM-së në lidhje me shëndetësimin e pyjeve për furnizimin me dru zjarri për banorët me banim të përhershëm në ZMM _________.

**A. Përputhshmëria ligjore të ndërhyrjes**
*Shkruaj vlerësimin*
**B. Plotësia e dokumentacionit të hartuar**
*Shkruaj vlerësimin*
**C. Argumentimi i nevojës për ndërhyrje**
*Shkruaj vlerësimin*
**D. Përshtatshmëria e teknikave të propozuara**
*Shkruaj vlerësimin*
**E. Intensiteti i ndërhyrjeve**
*Shkruaj vlerësimin*
**F. Arsyeshmëria e sasive materialit drusor të vlerësuar për tu gjeneruar**
*Shkruaj vlerësimin*
**G. Propozimi për Drejtorin e Përgjithshëm**

Përsa më sipër, Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrit të Zonave të Mbrojtura pas verifikimit të projektit për shëndetësimin e pyjeve për furnizimin me dru zjarri për banorët me banim të përhershëm në ZMM _________ konstaton se është në përputhje me planin e menaxhimit/kërkesat ligjore në rast emergjencash dhe kriteret teknike të tij. Në këto kushte Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrit të Zonave të Mbrojtura, miraton projektin teknik për ndëryrje për shëndetësimin e pyjeve për furnizimin me dru zjarri për banorët me banim të përhershëm në Parkun Kombëtar "Prespa".

Për efekt procedure, lutemi gjeni bashkëlidhur draft-Urdhrin për miratimin e projekteve teknike.

Duke Ju falënderuar,

Bashkëngjitur:

A. Draft Urdhri
B. Projekti Teknik final
C. Tabela Përmbledhëse për Objektet e Shëndetësimit të Pyjeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**
**DREJTORIA E MENAXHIMIT, MONITORIMIT DHE REGJISTRIT TË ZONAVE TË MBROJTURA**
**SEKTORI I MENAXHIMIT**

Nr. ________Prot. Tiranë, më, ____.____.202_

**Nr____, datë ___. ___ 202_**

**PËR**
**PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE TEKNIKE PËR FURNIZIMIN ME DRU ZJARRI, PËR FAMILJET ME BANIM TË PËRHERSHËM NË ZMM _____**

Referuar Ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, nenit 33, pika 2/ç, nenit 46, pikat 2, 3 dhe 4, VKM nr. 1156, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre", i ndryshuar, Rregullores "Mbi menaxhimin e procesit të ndërhyrjeve të nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve dhe furnizimin e komunitetit dhe subjekteve private lokale me materialin drusor/asortimentet e realizuara", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave nr. _____, datë ________, dhe bazuar në memon nr._____prot., datë____.____.202_, të Drejtorisë së Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrit të Zonave të Mbrojtura,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e projekteve teknike për shëndetësimin e pyjeve në ZMM ________, sipas teksit bashkëlidhur këtij Urdhri;
2. Afati për zbatimin e projektit teknik në terren do të jetë ____ ditë dhe do të zgjasë nga data _______ në datën ______.
3. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Administrata e Zonave të Mbrojtura, ______;
4. Për monitorimin e zbatimit të këtij Urdhri ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrit të Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKZM.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**I KOMANDUAR NË DETYRË**
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Daniel PIRUSHI**

Konceptoi:,Specialist
Kontrolloi: Përgj/Sektori
Miratoi:,Drejtor

## ANEKS 5

### TABELA PERMBLEDHESE PER OBJEKTET E SHENDETESIMIT TE PYJEVE VITI ______

**ADZM:** ________________
**ZMM:** ________________

| Nr | Emërtimi projektit | Objekti | Ekonomia pyjore | Ng./ n.ng. | Lloji drusor | Sip. ha | Volumi planifikuar | | Volumi realizuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | m3 | mst | m3 | mst |
| 1 | Pastrimi mbeturinave drusore | Faqe Çeltinës | Qarrishtë | 113a,211a | Ah | 25 | 150 | 250 | 101.4 | 169 |
| 2 | Pastrimi mbeturinave drusore | | | | | | | | | |
| 3 | Pastrim shëndetësim pyjesh | | | | | | | | | |
| 4 | Pastrim shëndetësim pyjesh | | | | | | | | | |
| | **TOTALI** | | | | | | | | | |

**Pergjegjesi i Sektorit te Menaxhimit**
Emer, Mbiemër, Firme

______________________________

**Drejtori i AdZM** ______________
Emer, Mbiemër, Firme, Vule

______________________________

Konfirmoi/ Kontrolloi mbështetur në dokumentacionin mbështetës të dorëzuar nga AdZM:

**Pergjegjesi i Sekt. Menaxhimit në AKZM**
Emer, Mbiemër, Firme

______________________________

**Drejtori i Drejtorisë përgjegjëse për Menaxhimin në AKZM**
Emer, Mbiemër, Firme

______________________________

## ANEKS 6

## LISTA E FAMILJEVE ME BANIM TË PËRHERSHËM PER VITIN 202_

**Bashkia** ______________________
**Njësia Administrative** ______________________
**Fshati** ______________________

***Shënim:*** *Një kopje e kësaj liste dërgohet në AdZM.*

| **Nr.** | **Kryefamiljari** (Emri Mbiemri) | **Nr. Kartës ID** | **Adresa** (fshati, lagjia) |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

## ANEKS 6

**AKZM** | AGJENCIA KOMBETARE E ZONAVE TE MBROJTURA

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Kryesia e fshatit**________________

**KRYETARI**

________________________
(Emer, Mbiemër, Firme, vula)

**Nj. Q. Vendore**__________________

**KRYETARI**

________________________
(Emer, Mbiemër, Firme, vula)

**PËR GJENDJEN CIVILE**

________________________
(Emer, Mbiemër, Firme, vula)

## ANEKS 7

## NJOFTIMI I FAMILJEVE ME BANIM TË PËRHERSHËM QE KANË TË DREJTË PËRFITIMI PËR DRU ZJARRI PËR VITIN 202_

**Bashkia** ____________________
**Njësia Administrative** ____________________
**Fshati** ____________________

***Shënim:*** *Lista shpallet në qendwr tw fshatit, nw Njësitë Administrative dhe në Bashkinë ______ për një afat 10 ditor, si dhe kryefamiljaret/familjaret njoftohen individualisht nga Kryetari i Fshatit. Lista përfshinë të gjitha familjet e listuara në Aneksin 6. Nëse nuk gjenden perfituesit, marrja dijeni konsiderohet e ezauruar me përmbushja e afatit 10 ditor dhe kryerjen e njoftimit individual nga Kryetari i Fshatit. Në këtë rast në formular vendoset data e njoftimit nga Kryetari i Fshatit dhe shenimi përkates. Familjaret që shprehin interes për të përfituar dru zjarri, plotësojnë më shkrimin e tyre të dhënat në Aneksin 8. Një kopje e kësaj liste tw finalizuar dërgohet në AdZM*

| **Nr.** | **Kryefamiljari** (Emri Mbiemri) | **Adresa** (fshati, lagjia) | **Data e marrjes dijeni** | **Nënshkrimi** (emër mbiemër, fimë) | **Shënime** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
